



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe nenit 40.2 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit për bashkëpunim ndër komunal nr.04/L-010, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/19, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0020890/24 të datës 29 mars 2024 për miratimin e Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, miratoi këtë,

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR THEMELIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËR - KOMUNAL

Neni 1

Me këtë vendim autorizohet z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal në mes Komunës së Podujevës dhe Komunave;

- Komuna e Vushtrrisë
- Komuna e Prishtinës
- Komuna e Mitrovicës së Jugut
- Komuna e Obiliqit

Neni 2

Kryetari i Komunës autorizohet po ashtu për fillimin e konsultimeve me Komunitat e cekura dhe përgatitjen e Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e nismës për bashkëpunim ndër – komunal, si dhe kompetencave të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 3

Marrëveshja nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, e njëjta procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës, ndërsa bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, dhe publikimit të të njëjtës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot.01-016/01-0020872/24
Podujevë, datë: 29 mars 2024

